

L I G J
Nr.7744, datë 26.7.1993

PËR MIRATIMIN E URDHËRIT "FLAMURI KOMBËTAR"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimin e urdhërit "Flamuri Kombëtar", i klasit I, II dhe III-të.

Neni 2

Urdhëri "Flamuri Kombëtar" u jepet shtetasve shqiptarë ose të huaj për merita të shquara në luftën për bashkimin e lartësimin e kombit, për unitetin kombëtar, lirinë dhe përparimin e atdheut.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.613, datë 29.7.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.